



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Nr. 206 Prot., Datë 19.01.2015

Nr. 1161 Prot., Datë 16.01.2015

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

### PËR KOMUNIKIMIN DHE SHKËMBIMIN E TË DHËNAVE

**Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave**, (referuar si ILDKPKI) në mbështetje të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, neni 17, shkronja “ç” bashkëpunon me organet e auditimit dhe me strukturat e tjera përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit dhe krimin ekonomik;

dhe

**Drejtoria e Përgjithshme e Doganave**, (referuar si DPD) në mbështetje të nr. 102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, neni 2, pika 3(d)(i) dhe neni 16, pika 3, bashkëpunon duke zhvilluar dhe thelluar marrëdhëniet e ndërsjellta ndërmjet autoriteteve doganore dhe agjencive të tjera qeveritare për të shmangur çdo konflikt ndërmjet interesit privat dhe interesit publik në ushtrimin e detyrës nga personeli doganor;

Referuar më poshtë si “Palët”, lidhin këtë Marrëveshje Bashkepunimi me kushtet dhe termat si më poshtë vijon:

## **Hyrje**

*Të vetëdijshme për rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për forcimin e shtetit ligjor, për të drejtën e informimit, për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi dhe të së drejtës ekonomike në veçanti;*

*Të vetëdijshme që ky bashkëpunim i ndërsjelltë do të rezultojë në një kontribut të efektshëm në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit;*

*Me dëshirën e mirë për të kontribuar në bashkëpunimin nëpërmjet zhvillimit të marrëdhënieve ndërmjet dy institucioneve;*

*Duke riafirmuar vendosmërinë e tyre për të kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në procesin e zbatimit të legjislacionit respektiv të dy institucioneve si dhe në Kodin e Procedurave Administrative dhe Kodin Civil, palët;*

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ka për qëllim:

1. Realizimin e komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave me qëllim rritjen e efikasitetit dhe bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve për forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik.
2. Koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të hetimit administrativ të zyrtarëve të administratës publike që mbartin detyrim për deklarim të interesave private, për të cilët ka filluar hetimi administrativ sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005.
3. Bashkëpunimin e palëve që do të realizohet mbi baza të njëjta dhe mbi parimin e reciprocitetit, përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

## **Neni 2**

### **Angazhimet e palëve**

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave angazhohen që të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në respekt dhe zbatim të kërkesave ligjore që burojnë nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” i ndryshuar, ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në

ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe Kodit Doganor, ku në mënyrë të veçantë:

1. DPD-ja angazhohet që të vej në dispozicion të ILDKPKI-së çdo informacion apo të dhënë që disponon, lidhur me kontrollin dhe verifikimin e të dhënave të deklaratës së interesave private të zyrtarëve-subjekte të ligjit për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.
2. DPD-ja angazhohet të marrë masa për të forcuar autoritetin përgjegjës, rolin dhe funksionet e tij për të këshilluar, trajtuar, kontrolluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesave (të vazhdueshëm dhe rast pas rasti) të zyrtarëve të administratës doganore, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005.
3. ILDKPKI-ja nga ana e saj angazhohet të vej në dispozicion të DPD-së çdo informacion apo të dhënë, të dalë nga verifikimi dhe kontrolli i deklaratave të interesave private të zyrtarëve të administratës doganore (deklarues), që i shërben veprimtarisë institucionale të DPD-së.
4. DPD-ja angazhohet të zbatojë propozimet e ILDKPKI-së për marrjen e masave disiplinore ndaj subjekteve deklaruese të administratës doganore, të cilët kanë shkelur ligjet nr. 9049, datë 10.4.2003 dhe nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar, dhe janë dënuar me masa administrative apo kallëzuar penalisht në organin e akuzës, nga ILDKPKI-ja. Në rastet kur DPD-ja nuk merr masa disiplinore, sipas propozimeve të ILDKPKI-së, duhet t’a njoftojë atë në mënyrë të arsyetuar me shkrim.
5. Palët angazhohen të bashkëpunojnë në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta që do i shërbejnë zbatimit të ligjeve respektive, veçanërisht në trajnime dhe takime pune me nëpunësit e dy institucioneve apo me autoritetet përgjegjëse.
6. Palët angazhohen të kërkojnë mendimet dhe sugjerimet e njëra - tjetrës, në rastet e nxjerrjes së rregulloreve, udhëzimeve apo amendimeve ligjore të propozuara, që prekin objektin e veprimtarisë së palës tjetër.

### **Neni 3**

#### **Komunikimi dhe koordinimi ndërmjet palëve**

1. Palët caktojnë persona kontakti, të cilët do të jenë përgjegjës për zbatimin konkret të Marrëveshjes, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm.

2. Komunikimi ndërmjet palëve do të jetë në formë shkresore si dhe në rrugë elektronike (e-mail), në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Në rastet e shmangies nga procedurat e përcaktuara në këtë Marrëveshje, palët merren vesh për procedura të pranueshme komunikimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 4**

##### **Rishikimi dhe monitorimi i zbatimit**

1. Palët bëjnë shtesa dhe ndryshime në këtë marrëveshje, bazuar në pëlqimin e ndërsjellë të paraqitur me shkrim.

2. Marrëveshja e miratuar dhe zbatimi i saj monitorohen në mënyrë periodike. Për shkak të natyrës së ndryshueshme të legjislacionit në fuqi dhe ndryshimeve procedurale të planifikuara në DPD, kjo Marrëveshje do të rishikohet plotësisht 12 muaj nga data e nënshkrimit të saj.

#### **Neni 5**

##### **Përfundimi i Marrëveshjes**

1. Kjo Marrëveshje mund të përfundojë nga secila Palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër, tre (3) muaj pas datës së marrjes të njoftimit të sipërpërmendur.

2. Deri në përfundimin e kësaj Marrëveshjeje, palët do t'u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin prej saj, përsa i përket informacionit dhe dokumentave të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të tij.

#### **Neni 6**

##### **Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhe të pa caktuar kohe.

2. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e palëve.

3. Marrëveshja hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe dy të tjera në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

**INSPEKTORATI I LARTË  
I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT  
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT  
TË INTERESAVE**

**Shkëlqim GANAJ**

**INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM**



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
E DOGANAVE**

**Elisa SPIROPALI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

